



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 161

3 tetor

2013

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|--|--|------|
| Vendim i KM nr. 840, datë 27.9.2013 | Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë” | 7237 |
| Vendim i KM nr. 841, datë 27.9.2013 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Financave | 7238 |
| Vendim i KM nr. 842, datë 27.9.2013 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë | 7240 |
| Vendim i KM nr. 843, datë 27.9.2013 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit | 7241 |
| Vendim i KM nr. 844, datë 27.9.2013 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës | 7242 |
| Vendim i KM nr. 845, datë 27.9.2013 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë | 7243 |
| Vendim i KM nr. 849, datë 30.9.2013 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të Stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.... | 7244 |

VENDIM
Nr. 840, datë 27.9.2013

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 833, DATË 18.9.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në ndarjen I, pas fjalëve “... fushave të përgjegjësive shtetërore...” shtohen “... e të organeve të varësisë...”.

2. Pas ndarjes III shtohet ndarja IV, me këtë përmbajtje:

“IV. Në përmbushje të misionit dhe të kompetencave të saj, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka organet e varësisë, si më poshtë vijon:

a) Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN);

b) Agjencinë Kombëtare Atomime (AKA);

c) Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH);

ç) Repartin e Inspektim-Shpëtim Minierave (RISHM);

d) Inspektoratin Qendror Teknik (IQT);

dh) Sekretariati “Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse” (NTIN).

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka në varësi administrative shoqëritë dhe ndërmarrjet në likuidim që veprojnë në fushën e përgjegjësive së saj, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E SHOQËRIVE TË MEI

| | |
|--------------------------|---------|
| “Albpetrol” sh.a. | Fier |
| “KESH” sh.a. | Tiranë |
| “OST” sh.a. | Tiranë |
| PetrolAlba | Tiranë |
| “Albminiera” sh.a | Tiranë |
| Kombinati Energjetik | Elbasan |
| “Prodhim Mobilje” sh.a | Tiranë |
| “NPV” sh.a. | Durrës |
| “Trikozazhi” sh.a. | Korçë |
| “Prodhim Këpuca” sh.a. | Korçë |
| “Beratex” sh.a. | Berat |
| “Nimex” sh.a. | Durrës |
| “Prodhim kablo” sh.a. | Shkodër |
| Uz 12 NI CO, në likuidim | Elbasan |



| | |
|----------------------------------|---------|
| Uz Superfosfatit, në likuidim | Laç |
| Ndërmarrja e Superfosfatit | Laç |
| Uz Plehrave Azotike, në likuidim | Fier |
| NP Çelikut | Elbasan |
| Nd Furnizimit Ind Miniera | Elbasan |
| Ndërmarrje Goma | |
| Fabrika e Çorapeve | |
| Sh.a. në likuidim | |
| Albbakër | Tiranë |
| Albkromi | Tiranë |

VENDIM

Nr. 841, datë 27.9.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Financave si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Misioni i Ministrisë së Financave është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

III. Ministria e Financave e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Politikën makroekonomike dhe fiskale;
2. Administrimin e të ardhurave;
3. Administrimin e buxhetit të shtetit;
4. Menaxhimin e borxhit publik;
5. Administrimin financiar;
6. Menaxhimin financiar dhe kontrollin;

7. Menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian dhe menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian;

8. Inspektimin financiar publik;
9. Bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm.

IV. Ministria e Financave, për realizimin e fushës së përgjegjësive, sipas pikës III të këtij vendimi, ka këto kompetenca:

1. Është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale, në të cilat përfshihen analizat makroekonomike, parashikimi i të ardhurave, politika e shpenzimeve publike, politika e taksave, politika e borxhit publik.

2. Është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e nismave dhe hapave ligjorë, me qëllim administrimin e të ardhurave, në të cilat përfshihen, kryesisht, administrimi i taksave dhe administrimi doganor.

3. Është përgjegjëse për hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, kontrolli i menaxhimit të investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë.

4. Është përgjegjëse për menaxhimin e borxhit publik, në të cilin përfshihen menaxhimi i portofolit të huamarrjes së brendshme dhe të huaj, menaxhimi i riskut të huamarrjes, si dhe shërbimi i regjistrimit të borxhit.

5. Është përgjegjëse për ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë e sektorit publik, nëpërmjet vendosjes së rregullave, standardeve, procedurave dhe monitorimit të zbatimit të tyre.

6. Është përgjegjëse për miradministrimin financiar të fondeve publike, i cili realizohet nëpërmjet ushtrimit të funksionit të thesarit, zbatimit të metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik dhe kontrollit të brendshëm financiar publik.

7. Është përgjegjëse për menaxhimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian. Në funksion të këtij mirëmenaxhimi është sigurimi i bashkëfinancimit si dhe ndjekja e zbatimit të kontratave. Ministria e Financave është përgjegjëse edhe për legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe për funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit të kontrollit në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA).

8. Është përgjegjëse për inspektimin financiar publik, si funksion i parashikuar me qëllim:

a) mbrojtjen e interesave financiarë të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit;

b) rregullshmërinë e transaksioneve e të veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik;

c) përcaktimin e shkeljeve të akteve normative, si dhe dyshimeve për mashtrimet e kryera;

ç) zbulimin e parregullsive e të dëmeve të shkaktuara në pronën e njësive publike;

d) identifikimin e shkeljeve e të individëve përgjegjës për parregullsitë e zbuluara.

9. Është institucioni i vetëm që bën bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditit të brendshëm.

10. Ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare, për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

V. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 842, datë 27.9.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

2. Ministria e Drejtësisë e ushtron veprimtarinë e saj në fushën e përgjegjësisë shtetërore, të parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

3. Ministria e Drejtësisë, për realizimin e fushës së përgjegjësisë sipas pikës 2, ushtron kompetencat e parashikuara në nenin 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

4. Ministria e Drejtësisë, për realizimin e fushës së përgjegjësisë së saj, ushtron edhe kompetencat që i njeh legjislacioni në fuqi për veprimtarinë e institucioneve qendrore në varësi të saj, si më poshtë vijon:

- a) Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit;
- b) Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- c) Avokaturën e Shtetit;
- ç) Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
- d) Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit;
- dh) Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë;
- e) Institutin e Mjekësisë Ligjore;
- ë) Komisionin Shtetëror të Ndihmës Juridike;
- f) Komitetin Shqiptar të Birësimit;
- g) Qendrën e Botimeve Zyrtare;
- gj) Shërbimin e Provës;
- h) Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

5. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 843, datë 27.9.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësive shtetërore e të organeve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton dhe zbaton politika që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, të komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t’u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut në përputhje me përparësitë, kombëtare dhe evropiane, krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies e të shërbimeve. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, integritimit kulturor, harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.

III. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Sektorin e edukimit parauniversitar;
2. Sektorin e arsimit të lartë;
3. Sektorin e zhvillimit të arsimit jopublik;
4. Sektorin e zhvillimit të sportit.

IV. Ministria e Arsimit dhe Sportit synon ofrimin e një edukimi cilësor në arsimin parauniversitar, arritje të standardeve bashkëkohore evropiane në arsimin e lartë, impulse konkrete në zhvillimin e sportit, si një aspekt thelbësor për konsolidimin e një shoqërie të shëndetshme.

V. Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për hartimin e strategjive e të politikave të zhvillimit të një sistemi arsimor cilësor që veprojnë në sektorët e fushës së përgjegjësive së saj. Kjo ministri mund ta ushtrojë këtë detyrë vetëm ose së bashku me ministri të tjera, sipas delegimit që i bën Këshilli i Ministrave, bazuar në legjislacionin për sistemin arsimor parauniversitar dhe atë të lartë, si dhe në legjislacionin për sportin.

VI. Në përmbushje të misionit dhe kompetencave të saj, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka organet e varësisë, si më poshtë vijon:

1. Njësitë arsimore vendore;
2. Agjencinë Kombëtare të Provimeve;
3. Inspektoratin Shtetëror të Arsimit;
4. Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë;
5. Institutin për Zhvillimin e Arsimit;
6. Qendrën e Studimeve Albanologjike;
7. Shtëpinë Botuese të Teksteve Mësimore;
8. Agjencinë e Shërbimit të Sporteve.

VII. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 844, datë 27.9.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e fushave të përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Kulturës, si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministri i Kulturës, në përputhje me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor në fuqi, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve, ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme në fushën e kulturës e të trashëgimisë kulturore.

III. Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritimit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

2. Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rritjes së vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

3. Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

4. Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.

5. Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar dhe të diversitetit kulturor.

6. Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.

7. Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

IV. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 845, datë 27.9.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË
TË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit e të fushave të përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka si mision garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje dhe përfshirje sociale, arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror, përkujdesje sociale dhe shanse të barabarta, garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët socialë, garantimin e lirisë së besimit fetar e të barazisë së bashkësive fetare dhe mbështet mirëkuptimin e tolerancën ndërfaqetare.

III. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e punësimit, arsimit dhe formimit profesional.

2. Zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e emigracionit dhe imigracionit të punës.

3. Zhvillimin e politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë.

4. Zhvillimin e politikave dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit e të veprimtarive që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore, si dhe procesin e bashkërendimit të punës për skemat e mbrojtjes shoqërore me vendet e tjera.

5. Zhvillimin e politikave, që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.

6. Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnicitetit dhe minoritetit.

7. Zhvillimin e politikave dhe modeleve për ndihmën dhe shërbimet shoqërore alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike.

8. Hartimin dhe rishikimin e standardeve për shërbime të ndryshme shoqërore dhe inspektimin e tyre për garantimin e një shërbimi cilësor.

9. Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social, në kuadrin e partneritetit, me qëllim harmonizimin e interesave të palëve për minimizimin e konflikteve sociale.

10. Bashkërendimin e punës dhe monitorimin e politikave ndërsektoriale të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale që hartohen dhe zbatohen në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucione të tjera qendrore.

11. Hartimin dhe zbatimin e politikave për mbështetjen e rinisë në të gjitha fushat e veprimtarisë.

12. Garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale.



13. Bashkëndimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare. Kjo ministri garanton asnjësinë në çështjet e besimit, njeh barazinë e bashkësive fetare dhe respekton pavarësinë e tyre. Punon për garantimin e lirisë së besimit e për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfetare në Shqipëri.

IV. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është përgjegjëse për hartimin e strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale, që përfshijnë fushat e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi.

V. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 849, datë 30.9.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 474, DATË 10.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË STEMËS SË REPUBLIKËS, SI DHE RAPORTIN E PËRMASAVE TË SAJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, për përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, të pikës 4, fjalët “... përmasat 11/15 mm ...” zëvendësohen me “... përmasat 14/18.5 mm ...”.

2. Figura 4, modelet “a” dhe “b”, e shtojcës bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



Fletorja Zyrtare
e Republikës së Shqipërisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 3.10.2013
Doli nga shtypi më 3.10.2013

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 18 lekë